

Vendim nr. 180 datë 18.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 18.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (L) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: LEJLA LIBOHOVA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 9533, datë 03.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1158, datë 14.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-4473, datë 09.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe neni 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Lejla Libohova dhe shtetasi K.B., i cili ushtron shërbimin e avokatisë pranë një studioje ligjore, kanë lidhur një kontratë porosie, që ka shënim datën 15.01.2010, sipas së cilës avokati K.B. ka marrë përsipër ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore pranë ish-

Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) për njohjen, kthimin ose kompensimin e pronave në favor të kërkueses dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të ish-pronarit. Afati i kontratës ishte nga data e nënshkrimit të saj deri më 31.12.2010. Si shpërblim për shërbimin e ofruar, avokati do të merrte 8% të shumës që kërkuësja do të përfitonte nga procesi i kompensimit të pronës. Kontrata është formuluar në formën e një akti noterial, ku në pjesën hyrëse thuhet se palët janë paraqitur para noteres E.Q., por ajo është nënshkruar vetëm prej tyre dhe nuk rezulton që të jetë nënshkruar nga noterja.

2. Me VKM-në nr. 204, datë 19.02.2009 “Për shpronësimin e pronarëve, për sipërfaqet takuese, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale” (VKM nr. 204/2009) janë miratuar shpërblimet për sipërfaqet përkatëse, ku përfshihet si përfituese edhe kërkuësja. Në bazë të këtij vendimi janë marrë vendimet e AKKP-së për pagesat faktike, në këste, në shumat konkrete që do të përfitonin subjektet e përcaktuara në të. Sipas kësaj VKM-je, kërkuësja është paguar për një pjesë të shpërblimit të përfituar nga procesi i njohjes dhe kompensimit të pronës, konkretisht në masën 57% dhe pritej t'i akordoheshin edhe shuma të tjera, deri në shpërblimin e plotë të kompensimit financiar.

3. Shtetasi K.B. i është drejtuar me padi gjykatës, me të paditur kërkuësen, me objekt përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kontrata e porosisë e datës 15.01.2010, duke pretenduar se kërkuësja nuk i ka shlyer detyrimet karshi tij për shërbimin e kryer, ndërkohë që ai i ka përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga ajo kontratë.

4. Kërkuësja, gjatë gjyqimit në shkallë të parë, ka prapësuar se në datën 15.01.2010, kur është lidhur kontrata e porosisë, ajo ndodhej jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nënshkrimi i saj është i falsifikuar. Në këto kushte ka filluar procedimi penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP), për rrjedhojë gjykimi civil i kësaj çështjeje është pezulluar.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 04.04.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke konkluduar se mosmarrëveshja ka natyrë civile dhe nuk ka elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Më tej, kërkuësja ka hequr dorë nga pretendimi për falsitetin e nënshkrimit, por ka pretenduar se data e kontratës së porosisë nuk është e saktë, për rrjedhojë nuk mund të përcaktohet se kur ka filluar të prodhojë efekte ajo. Po ashtu, sipas saj, kontrata është e pavlefshme, pasi akti noterial është i parregullt dhe nuk është nënshkruar nga noteri dhe se për shërbimet e kryera avokati K.B. është shpërblyer. Nga ana tjetër, avokati K.B. ka pretenduar se data e kontratës është një

lapsus, megjithatë marrëdhënia midis palëve ndërgjyqëse nuk ka lindur kur është lidhur kontrata me shkrim, por ka ekzistuar më parë. Sipas tij, kontrata nuk duhet të kualifikohet se është bërë me akt noterial, në kushtet ku nuk është nënshkruar nga noteri, por si shkresë e thjeshtë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9533, datë 03.10.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e kërkueses të përmbushë detyrimet kontraktore të marra përsipër në kontratën e porosisë, duke i paguar avokatit K.B. shumën 47,908 USD, si dhe interesat e kësaj shume deri në çastin e ekzekutimit të vendimit, sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë për depozitat me afat 1-vjeçar. Sipas gjykatës, kërkuësja duhet të përmbushë detyrimet sipas kontratës së porosisë dhe të paguajë vlerën 8% të shumës respektive të mbetur që do të përfitojë në zbatim të VKM-së nr. 204/2009 për avokatin K.B. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1158, datë 14.05.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën mënyrë sikurse ajo gjykatë. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Pala paditëse në procesin gjyqësor, avokati K.B., ka paraqitur kundërrekurs, duke parashtruar se rekursi është bërë në kundërshtim me kërkesat e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 380, datë 01.07.2015, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1158, datë 14.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Në lidhje me rekursin, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-4473, datë 09.11.2022, ka vendosur mospranimin e tij, si dhe revokimin e vendimit nr. 380, datë 01.07.2015 për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Sipas tij, në rastin konkret nuk është ngritur asnjë shkak ligjor për cenimin e vendimeve të gjykatave të faktit, nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe se nuk konstatohen shkelje të ligjit material ose procedural nga ana e gjykatave më të ulëta.

10. Në datën 09.05.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkueses

11. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga procesi gjyqësor i kundërshtuar i është cenuar:

11.1. *Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit*, pasi gjykata e rrethit gjyqësor dhe ajo e apelit kanë gabuar në interpretimin e ligjit, ndërkohë që Gjykata e Lartë, edhe pse pas 7 vjetësh pritje, nuk e ka gjykuar çështjen në themel, pavarësisht shkaqeve të rekursit. Provat dhe faktet e paraqitura nga kërkuesja nuk janë marrë parasysh nga gjykatat. Kontrata e paraqitur nga paditësi K.B. nuk është në formën e kërkuar nga ligji dhe në fund të kontratës është shënuar noteri, por mungon firma dhe vula e tij. Kërkuesja nuk ka pasur asnjë kontakt me paditësin dhe ai nuk ka kryer asnjë shërbim për llogari të saj, por pasi është vënë në dijeni për VKM-në nr. 204/2009 ka paraqitur këtë kontratë të njëanshme para gjykatës. Në gjykim është provuar se në datën e lidhjes së kontratës kërkuesja ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë. Mungesa e datës është një element thelbësor i kontratës pa të cilën nuk mund të përcaktohet fillimi dhe kohështirja e saj. Ndryshe nga sa kanë pranuar gjykatat, në asnjë pikë të kontratës nuk thuhet se ajo është vazhdim i një marrëveshjeje të mëparshme joformale midis palëve dhe për shërbimet e kryera avokati është shpërblyer. Po kështu, edhe pse gjykata pranon se kontrata ka efekte për periudhën janar-dhjetor 2010, në kundërshtim me këtë njeh përfitimet e avokatit për vendimet e Këshillit të Ministrave të dala në vitin 2009, duke i dhënë atij të drejta e përfitime përtej afatit të përcaktuar në kontratë dhe për shërbime të papërcaktuara. Në gjykim nuk u paraqit nga paditësi asnjë provë për të vërtetuar se ku është përdorur kjo kontratë për përfaqësimin e interesave të kërkueses. Ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat, paditësi nuk mund të marrë 8% të shumës së kompensimit, pavarësisht kontributit të tij. Afati i kontratës ka qenë deri në datën 31.12.2010, që do të thotë se kjo është periudha brenda së cilës ai do të kryejë porosinë dhe do të marrë shpërblimin për punën e kryer.

11.2. *E drejta për t'u njoftuar*, pasi gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar pa u njoftuar kërkuesja, si palë e paditur në proces, pretendim ky që është ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

11.3. Gjykimi në gjykatën e apelit është zhvilluar pas 6 muajsh nga marrja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që normalisht gjykimet në atë gjykatë

variojnë nga 10-14 muaj. Për më tepër, në rastin konkret nuk ka pasur ndonjë kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

11.4. *E drejta e aksesit e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen në seancë gjyqësore dhe duke mos i dëgjuar pretendimet e palëve, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material. Ky vendim bie në kundërshtim me jurisprudencën e mbajtur nga i njëjti kolegji në raste të tjera. Vendimi i Kolegjit Civil nuk është dhënë publikisht, por në dhomë të këshillimit, duke i mohuar kërkueses të drejtën për t'u dëgjuar edhe pse çështja e kërkueses nuk përfshihet në ato raste ku publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Duke verifikuar plotësimin e këtyre kriterëve në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë është bartëse e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt të pretenduar të cenuar.

14. Një kriter tjetër që duhet të plotësojë ankimi kushtetues individual është ai i *shterimit të mjeteve juridike efektive*. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000,

individui mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 23, datë 29.04.2021; nr. 54, datë 24.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqimit të zakonshëm. Kurse në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkesja nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-4473, datë 09.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kurse kërkesa është regjistruar në Gjykatë në datën 09.05.2023. Bashkëlidhur kërkesës, kërkesja ka paraqitur një shkresë ku i ka kërkuar informacion Gjykatës së Lartë për vendimin e arsyetuar, datën dhe hedhjen e tij në sistem. Kjo e fundit ka sqaruar se çështja civile nr. 11220-02218-00-2015 regjistri themeltar, datë 30.06.2015 ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-4473, datë 09.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të internetit të asaj gjykate, duke u bërë në këtë mënyrë i disponueshëm për palët në datën 28.01.2023. Kolegji, duke iu referuar kësaj date si ajo nga e cila kërkesja ka marrë dizeni efektivisht për vendimin dhe i është dhënë mundësia të njihet me shkaqet e tij, për rrjedhojë si data nga e cila fillon afati ligjor 4-mujor, vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin në shkallë të parë, i cili është zhvilluar në mungesë të saj si palë e paditur në proces, pretendim ky që është ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji vëren se, sipas vendimit gjyqësor të gjykatës së

shkallës së parë, kërkesja ka marrë pjesë në disa seanca gjyqësore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të saj, të caktuar fillimisht me deklaram dhe më pas me prokurë. Në seancën e datës 01.10.2014 ajo nuk është paraqitur edhe pse ka pasur dijeni dhe gjykimi ka vijuar në mungesë. Pretendimin për gjykimin në mungesë në shkallë të parë kërkesja e ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe kjo e fundit, pasi e ka marrë në shqyrtim, i ka kthyer përgjigje se ai është ngritur për herë të parë në rekurs, për rrjedhojë ka rënë në dekadencë sipas nenit 459 të KPC-së.

18. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se kërkesja vetëm sa e ka përmendur në kërkesë, por nuk ka paraqitur, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, argumente në mbështetje të tij. Kërkesja nuk ka saktësuar se cilave seanca gjyqësore u referohet, si dhe cilat janë ato parregullsi ose veprime/mosveprime të gjykatës së shkallës së parë që kanë shkaktuar mosnjohimin e saj, për rrjedhojë mungesën në atë gjykim. Pra, për sa kohë që kërkesja nuk ka paraqitur argumente me natyrë kushtetuese në lidhje me këtë pretendim, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Kërkesja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi gjykatat e faktit kanë gabuar në interpretimin e ligjit, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk e ka gjykuar çështjen në themel, pavarësisht shkaqeve të rekursit. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh provat dhe faktet e paraqitura në gjykim nga kërkesja. Kontrata e paraqitur nga paditësi K.B. nuk është në formën e kërkuar nga ligji dhe në fund të kontratës është shënuar noteri, por mungon firma dhe vula e tij. Kërkesja nuk ka pasur asnjë kontakt me paditësin dhe ai nuk ka kryer asnjë shërbim për llogari të saj, por pasi është vënë në dijeni për VKM-në nr. 204/2009 ka paraqitur këtë kontratë të njëanshme para gjykatës. Sipas saj, në gjykim është provuar se në datën e lidhjes së kontratës ajo ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë. Mungesa e datës është një element thelbësor i kontratës, pa të cilën nuk mund të përcaktohet fillimi dhe kohështirja e saj. Ndryshe nga sa kanë pranuar gjykatat, në asnjë pikë të kontratës nuk thuhet se ajo është vazhdim i një marrëveshjeje të mëparshme joformale midis palëve dhe për shërbimet e kryera avokati është shpërblyer. Po kështu, edhe pse gjykata pranon se kontrata ka efekte për periudhën janar-dhjetor 2010, në kundërshtim me këtë njeh përfitimet e avokatit për vendimet e Këshillit të Ministrave të dala në vitin 2009, duke i dhënë atij të drejta e përfitime përtej afatit të përcaktuar në kontratë dhe për shërbime të papërcaktuara. Në gjykim nuk u paraqit nga paditësi asnjë provë për të vërtetuar se ku është përdorur kjo kontratë për përfaqësimin e interesave të kërkuases. Kërkesja ka pretenduar se ndryshe nga sa kanë

arsyetuar gjykatat, paditësi nuk mund të marrë 8% të shumës së kompensimit, pavarësisht kontributit të tij. Afati i kontratës ka qenë deri në datën 31.12.2010, që do të thotë se kjo është periudha brenda së cilës paditësi do të kryejë porosinë dhe do të marrë shpërblimin për punën e kryer.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016; nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 3, datë 20.01.2017; nr. 16, datë 19.04.2013; nr.14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se këto pretendime të kërkuases, në thelb, kanë natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, pasi kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit dhe të vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Kërkesja nuk ka arritur t'i ngrejë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në procesin civil.

22. Kolegji vëren se kërkesja ka parashtruar se gjykimi në gjykatën e apelit është zhvilluar pas 6 muajsh nga marrja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, edhe pse normalisht gjykimet në atë gjykatë variojnë nga 10-14 muaj, për më tepër që nuk ka pasur ndonjë kërkesë për përshpejtim. Në lidhje me këtë pretendim Kolegji vëren se ai nuk është ngritur në drejtim të tejzgjatjes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të çështjes, por për prioritetin që i ka dhënë gjykata e apelit shqyrtimit të kësaj çështjeje, duke e gjykuar, sipas kërkuases, brenda një kohe më të shkurtër se sa koha mesatare brenda së cilës ajo gjykatë shqyrton

çështjet. Në këtë kuptim, edhe në lidhje me këtë pretendim, kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues cenimin e të drejtave të saj për shkak të kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes civile në gjykatën e apelit.

23. Po në kuptim të legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimi tjetër i ngritur nga kërkuesja për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë është i tillë që bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar

24. Sipas kërkueses, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen në seancë gjyqësore dhe duke mos i dëgjuar pretendimet e palëve, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material. Ky vendim bie në kundërshtim me jurisprudencën e mbajtur nga i njëjti kolegji në raste të tjera. Vendimi i Kolegjit Civil nuk është dhënë publikisht, por në dhomën e këshillimit, duke i mohuar kërkueses të drejtën për t'u dëgjuar, edhe pse çështja e kërkueses nuk përfshihet në ato raste ku publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

25. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kolegji vëren se në nenin 472 të KPC-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 480 të KPC-së parashikohen rastet kur vendoset mospranimi

i rekursit, dhe se ai vendoset në dhomë këshillimi, në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

27. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë. Kolegji Civil, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin, i ka dhënë përgjigje kërkueses se në të nuk është ngritur asnjë shkak ligjor për cenimin e vendimeve të gjykatave të faktit, nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Ai ka vlerësuar se nuk konstatohen shkelje të ligjit material ose procedural nga ana e gjykatave më të ulëta dhe se ato kanë garantuar një proces të rregullt ligjor dhe një hetim të plotë e të gjithanshëm të fakteve juridike objekt i mosmarrëveshjes. Kolegji Civil i ka kthyer përgjigje kërkueses në lidhje me pretendimet për gjykimin në mungesë në shkallë të parë, ashtu edhe në lidhje me provat e paraqitura nga palët në atë gjykim, duke vlerësuar se palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente me kërkesë për rishikim, si dhe në lidhje me pretendimet për kontratën e porosisë (*shih paragrafin 26 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

28. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për një proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Civil ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.